


# IDETË TONA



# PËRPARIMTARE

# INSTITUCIONET UDHËHEQËSE

SEMRANA (13), RILIND (13), EDUARD (13), DANUSH (13), ERIONA (14), GENTRITA (14)




**Ne jemi grupi i cili ka shkruar për ndarjen e pushtetit. Prandaj, nëse dëshironi të dini më shumë për këtë temë mund të lexoni artikullin më poshtë**

Fillimisht diskutuam për demokracinë. Më pas biseduam për ndarjen e pushtetit. Pushteti ndahet në tri degë: në Pushtetin Legjislativ, Pushtetin Ekzekutiv dhe Pushtetin Gjyqësor. Në Pushtetin Legjislativ bën pjesë Kuvendi i Kosovës. Në Pushtetin Ekzekutiv bën

Qeveria, deputetët, Presidenti dhe qytetarët mund të propozojnë projektligje në Kuvendin e Kosovës. Afër 95% të projektligjeve i propozon Qeveria. Qeverinë e përbëjnë Kryeministri, zëvendës kryeministrat, ministrat dhe zëvendës ministrat. Detyrë e Qeverisë është të ekzekutojë ligjet, të cilat miratohen nga Kuvendi i Kosovës. Kurse, gjykatat ndahen në: Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Gjykatat në Kosovë vënë rendin dhe drejtësinë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Mirëpo, ne pyesim pse duhet të ndahet puna e institucioneve tona? Të gjitha institucionet kanë përgjegjësitë e tyre, por ato bashkëpunojnë në mes vete. Kjo është e njëjtë sikur ne fëmijët nëse dëshirojmë të luajmë një lojë. Secili prej neve ka rolin e vet, por duhet kontributi i secilit për atë lojë. Prandaj, ne themi se institucionet duhet të punojnë në mënyrë të ndarë. Kështu edhe forcohet demokracia.



pjesë Qeveria. Ndërsa, në Pushtetin Gjyqësor bëjnë pjesë gjykatat.

Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, prej të cilëve 100 janë nga komuniteti shqiptar, ndërsa 20 të tjerë iu përkasin komuniteteve jo shumicë si: serb, romë, turk, boshnjak, etj. Prej 120 deputetëve, 10 janë deputetë të komunitetit serb. Kjo rregullohet sipas Kushtetutës së Kosovës. Deputetët e Kuvendit zgjedhen nga qytetarët e Kosovës. Puna e Kuvendit është të miratojë ligjet.



Ja se si duket e ardhmja e Kosovës

# INTERVISTA JONË ME QYTETARËT AKTIV

ALMIR (13), BELINDA (13), ELTA (13), ENDRITA (13), BLEONA (15), ROBERT (15), LEORIAN (15)

Ne vijmë nga shkolla „Idriz Seferi“ dhe sot të gjithë ne jemi gazetarë në „Demos-ti“. Meqë tema e grupit tonë është qytetaria aktive, ne intervistuar disa qytetarë të Kosovës

Sot patëm mundësinë të realizojmë intervistë, për herë të parë në jetën tonë. Pyetjet e grupit tonë për qytetarët ishin: cilat janë disa nga mënyrat që mund të jemi aktiv në demokraci dhe cili është kontributi i qytetarëve në demokraci. Ne e diskutuam edhe në grup, mirëpo edhe nga përgjigjet e qytetarëve e kuptuam se, të jesh aktiv në vendin tënd do të thotë të sigurosh një të ardhme të mirë dhe të sigurtë për të gjithë. Andaj lexues të nderuar, asnjëherë mos e harroni se ne jemi vetë demokracia. Demokracia na ofron të drejta, por edhe ne kemi përgjegjësi ndaj saj. Shteti ynë është si një fëmijë që rritet me kujdesin, dashurinë dhe përkushtimin e të gjithëve. Prandaj, t'i falim vendit tonë gjithë kujdesin, dashurinë dhe përkushtimin për të cilin ka nevojë. Të mos harrojmë se përgjegjësi e të gjithë neve është respektimi i ligjit, respektimi i njëri-tjetrit, pagesa e tatimeve, mbrojtja e pronave publike, etj. Nëse të gjithë i kryejmë përgjegjësitë tona, vendi ynë do të jetë gjithmonë i suksesshëm. Pra, ne qytetarët jemi shtylla bazë e demokracisë. Me të drejtat që kemi ne jetojmë të lumtur. Gjithsesi, ne ju ftojmë të lexoni më poshtë për të kuptuar përgjigjet që na dhanë qytetarët sot. Pos përgjigjeve, ne morëm edhe disa këshilla se si duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të mësojmë shumë. Ne ju premtojmë se do t'i dëgjojmë këto këshilla.



Gazetarët gjatë punës

Qytetarët mund të jenë aktiv duke adresuar problemet tek institucionet përkatëse



Kadri Malsiqi, qytetar gjatë intervistës

Qytetari duhet të jetë aktiv duke marrë pjesë në organizata dhe në shoqata rinore, por më e rëndësishmja në procesin zgjedhor



Suzana Elshani, duke u përgjigjur në pyetjen tonë


Të gjithë ne duhet të jemi më të vetëdijshëm, të kemi mirëkuptim, por edhe të jemi aktiv në referendume e peticione



Raif Gashi dhe ne, në intervistën tonë duke bashkëpunuar

## VOTA JONË KA VLERË

AVNI (13), ARIJETA (15), ERVIN (14), LEORITA (14), RAHMELLA (14), SUAD (15)



**Zgjedhjet janë proces përmes të cilit ne si qytetarë me anë të votës, vendosim për të ardhmen e vendit tonë. Pra, pjesëmarrja në procesin zgjedhor na e bën të mundur të bëhemi pjesë e bashkëqeverisjes**

Ne zgjedhim kur kemi dy e më shumë alternativa përpara nesh. Për të zgjedhur alternativën më të mirë, mund të marrim edhe mendime nga të tjerët. Njeriu edhe në jetën e përditshme bën zgjedhje. Zgjedhjet janë të llojllojshme. Nga një zgjedhje mund të varet e ardhmja jonë. Njëri nga shembujt tanë është vendimi për zgjedhjen e profesionit më të mirë për neve. Për këtë mund të dëgjojmë edhe mendimet e të tjerëve, mirëpo ne jemi të lirë të zgjedhim vet. Shembull tjetër, në jetën e përditshme është zgjedhja e një kënge që dëshirojmë ta dëgjojmë, që edhe nëse nuk e bëjmë zgjedhjen e duhur nuk ndikon në të ardhmen tonë. Me kalimin e kohës, ashtu siç kanë ndryshuar shumë gjëra, ka ndryshuar edhe demokracia dhe mënyra për të zgjedhur. Për fat të mirë, demokracia ka ndryshuar pozitivisht. Në vitet e para të demokracisë gratë, të moshuarit dhe të varfërit nuk kanë pasur të drejtë për të votuar. Nga kjo kuptojmë se zgjedhje kanë bërë vetëm burrat nga shtesa e pasur e popullsisë. Kjo do të thotë se më herët ka pasur diskriminim. Me kalimin e kohës, diskriminimi është zbehur. Pra, sot të gjithë i gëzojmë të drejtat e barabarta. Në Kosovë kemi dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet qendrore. Me zgjedhje komunale kuptojmë

votimin e qytetarëve për kryetarin e asaj komune. Kandidati, i cili fiton më së shumti vota zgjedhet kryetar i komunës përkatëse. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore, qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e vet, që ndryshe njihen si deputetë.



Këtu jemi duke dhënë ide rreth artikullit tonë

# PËRFAQËSUESIT E POPULLIT



**Të jesh deputet do të thotë të jesh i ditur, të jesh i drejtë, të jesh i afërt me popullin, si dhe t'i përfaqësosh interesat dhe nevojat e popullit. Me pak fjalë, të jesh zëri i popullit!**

Pasi që jeni informuar më shumë për zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre, në këtë artikull do të informoheni më shumë për përfaqësuesit e popullit, të cilët janë deputetët. Këta përfaqësues votohen në zgjedhjet qendrore dhe janë në shërbim të popullit për 4 vjet. Dikush mund të pyet se a kanë të drejtë të gjithë qytetarët të kandidojnë për deputet apo janë vetëm një pjesë e caktuar e shoqërisë që e gëzojnë këtë të drejtë? Të drejtën për të kandiduar për deputet, e gëzon çdo qytetar, i cili ka arritur moshën 18 vjeçare. Pra, vetëm mosha është kriter kyç që mund të pengojë ndonjë qytetar për të kandiduar për deputet. Vet fjala deputet e ka kuptimin përfaqësues, e kjo

menjëherë na bën të kuptojmë se deputetët kanë detyra dhe përgjegjësi të shumta. Vendi ku punojnë këta deputetë është Kuvendi ose ndryshe Parlamenti. Kuvendi i Kosovë ka gjithsej 120 përfaqësues, të cilët iu përkasin etnive të ndryshme. 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të tjerë iu përkasin komuniteteve të tjera jo shumicë. Të gjithë deputetët brenda Kuvendit, trajtohen në mënyrë të barabartë dhe çdo njëri prej tyre është i lirë të shprehë lirshëm mendimin dhe qëndrimin e tij/saj. Kjo sepse edhe vet Kuvendi është institucioni më demokratik në vendin tonë, dhe nga deputetët kërkon që të kenë ide, vizion dhe qëllime të mira për vendin.



**Unë, kam të drejtë të kandidoj për deputet pasi të arrijë moshën 18 vjeçare**



**Këtu grupi ynë ka shkruar disa fakte për institucionin e Kuvendit**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga:  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit:  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga:  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Idriz Seferi“  
Klasa: IX-1 & VIII-1  
Vendi: Strezovc, Kamenicë